

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Broshurë 3-mujori i parë
Janar - Mars 2026



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



Përgjegjësia Sociale e Korporatave (CSR) vijon të mbetet një element thelbësor i qasjes strategjike të bankave në Shqipëri, duke pasqyruar përkushtimin e tyre përtej funksionit tradicional financiar. Kjo qasje nënvizon rolin aktiv të sektorit bankar në promovimin e një shoqërie më të drejtë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Gjatë periudhës janar – mars 2026, institucionet bankare kanë vazhduar të ndërmarrin iniciativa me ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e mjedisit, në mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe në forcimin e kujdesit social, duke konfirmuar se qëndrueshmëria mbetet një komponent i rëndësishëm i planeve të tyre afatgjata.

Nëpërmjet mbështetjes së arsimit, projekteve me karakter social dhe nismave në fushën e mjedisit, bankat po forcojnë më tej bashkëpunimin me komunitetet dhe po kontribuojnë në krijimin e një vlere të qëndrueshme për shoqërinë dhe ekonominë shqiptare.

MJEDISI

EKONOMIA

SHOQËRIA

EDUKIM
FINANCIAR





DIMENSIONI EKONOMIK

BANKA E PARË E INVESTIMEVE SHQIPËRI (FIBANK)

- mbështeti mbrëmjen gala të “Shkodra Tourism Awards 2025”, ku u ndanë 30 çmime për aktorët kryesorë të turizmit, mikpritjes, gastronomisë dhe inovacionit, duke kontribuar në promovimin e Shkodrës si destinacion konkurrues dhe në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe komunitar.
- u bë pjesë e Albanian Power Exchange (ALPEX) si Agjent i Përgjithshëm Klerimi për Shqipërinë, duke mbështetur zhvillimin e tregut kombëtar të energjisë në rritjen e transparencës dhe stabilitetit të tregut energjetik.



BANKA INTESA SANPAOLO SHQIPËRI

- u vlerësua me çmimin “Banka më e Mirë për ESG në Shqipëri 2026” nga Global Banking & Finance Awards®, duke rikonfirmuar angazhimin për veprimtari bankare të përgjegjshme dhe të qëndrueshme, si dhe integrimin e suksesshëm të parimeve ESG në strategjinë dhe modelin e biznesit.
- u certifikua për vitin 2026 si “Top Employer” nga Instituti Top Employers, duke reflektuar angazhimin për zhvillimin e një kulture organizative dhe një mjedisi pune gjithëpërfshirës dhe mbështetës për punonjësit.



BANKA PROCREDIT SHQIPËRI

- sponsorizoi eventin për përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri dhe prezantimin e “White Book”, të organizuar nga Foreign Investors Association of Albania (FIAA), duke mbështetur dialogun dhe reformat që nxisin një mjedis të qëndrueshëm dhe të besueshëm për investime.



UNION BANK

- nënshkroi marrëveshje me BERZH dhe BE për zgjerimin e garancisë deri në 25 milionë euro për financimin e bizneseve të vogla dhe të mesme në Shqipëri, që nxit financimin e projekteve të gjelbra dhe zgjerimin e përfshirjes financiare në vend.
- nënshkroi marrëveshje të re garancie me ADGF, duke zgjeruar bashkëpunimin për zbatimin e EU Guarantee Window, përmes ofrimit të garancive për kreditë e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, me synim forcimin e qëndrueshmërisë së tyre dhe përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian.



7 ENERGJI E PËRBALLUESHME



8 PUNE DOKUMENTOHE DHE RITJETE EKONOMIKE



9 INDUSTRI INOVACION DHE INFRASTRUKTURE



11 OFIETË DHE KOMUNITETE TE QENDRUESHME



12 KOHËSI DHE PROGRAMI I PËRZGJESHËM





SHOQËRIA

BANKA KOMBËTARE TREGTARE (BKT)

- mbështeti organizimin e aktivitetit “Sofra e Elbasanit”, që shënon nisjen e festimeve për Ditën e Verës në Elbasan, duke kontribuar në forcimin e identitetit kulturor dhe përfshirjen e brezave të rinj në ruajtjen e saj.



BANKA CREDINS

- iu bashkua panairit “Work and Study”, duke informuar të rinjtë mbi politikat e punësimit dhe programet alternative që banka ofron.
- organizoi në hollin e bankës ekspozitat artistike personale “Jetë në Kanavacë” nga Kastriot Celmeta dhe “Pasionë Shpirtërore” nga Blerta Xhomo, me synim mbështetjen e artistëve dhe krijimin e një hapësire të dedikuar për prezantimin e veprave të tyre, për vizitorët dhe klientët.
- mbështeti koncertin artistik “Nën tingujt e Beethoven”, me synim sjelljen e vlerave të artit kombëtar dhe ndërkombëtar për publikun.



BANKA E PARË E INVESTIMEVE SHQIPËRI (FIBANK)

- promovoi marrëveshjen e sponsorizimit me Federatën Shqiptare të Skive për sezonin 2025–2026, duke mbështetur zhvillimin e talenteve të reja në sportet dimërore, promovimin e kulturës sportive dhe përfaqësimin ndërkombëtar të Shqipërisë.
- organizoi një nismë dhurimi gjaku, ku punonjësit e bankës kontribuan vullnetarisht në mbështetje të personave në nevojë, duke reflektuar angazhimin për solidaritet.
- organizoi një aktivitet për forcimin e ekipit (teambuilding) për punonjësit, duke forcuar bashkëpunimin, komunikimin dhe marrëdhëniet ndërpersonale, si dhe duke promovuar një mjedis pune pozitiv, motivues dhe të qëndrueshëm.
- mbështeti një performancë artistike me violinistin Ray Chen, të zhvilluar në Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit në Tiranë, duke kontribuar në promovimin e muzikës klasike dhe pasurimin kulturor, si dhe në nxitjen e ekselencës artistike dhe zhvillimit kulturor në vend.






BANKA INTESA SANPAOLO SHQIPËRI

- mori pjesë në panairin kombëtar “Work & Study”, duke u angazhuar drejtpërdrejt me studentë dhe të rinj për prezantimin e mundësive të karrierës, programeve të zhvillimit profesional dhe kulturës organizative.
- zhvilloi edicionin e katërt të konkursit “S.A.V.E. International Ambassadors” në bashkëpunim me Grupin Intesa Sanpaolo dhe Muzeun e Kursimeve në Torino, duke angazhuar nxënësit e gjimnazeve “Sami Frashëri”, “Qemal Stafa”, “Ismail Qemali” dhe “Besnik Sykja” në zhvillimin e projekteve mbi sfida mjedisore, sociale dhe ekonomike.
- u shpall fituese e Kampionatit të Ping Pongut për Bizneset, ku u përfaqësua nga punonjësit e saj dhe arriti vendin e parë përmes performancës së Artur Bakia, duke kontribuar gjithashtu në mbështetjen e komunitetit përmes dhurimit të dy tavolinave ping pongu për një shkollë 9-vjeçare në Tiranë në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Ping Pongut.

BANKA OTP SHQIPËRI

- mbështeti botimin e librit “Përtej Maleve” të autorit Eduard Lekgjika, duke kontribuar financiarisht në procesin e redaktimit dhe përgatitjes për publikim, si pjesë e angazhimit për promovimin e artit dhe kulturës.
- mbështeti sportistët e rinj të tenisit Denis dhe Jonis Gaba (U-18), përmes një sponsorizimi financiar për pajisje dhe uniforma sportive, duke kontribuar në zhvillimin e talenteve të reja, promovimin e sportit dhe nxitjen e një stili jetese të shëndetshëm.
- mbështeti me pajisje dhe materiale institucionet publike, duke dhuruar 10 kompjuterë desktop për Shkollën e Mesme të Gjuhëve të Huaja “Asim Vokshi”, në funksion të pajisjes së laboratorit dhe përmirësimit të infrastrukturës mësimore.



6 UJË I PASTER DHE KANALIZIME



13 VEPRIM PËR KLIMEN



14 JETA NEN UJË



15 JETA ME STERE



5 BARAZI GJYORJE



10 PËRQËNDËRJA E PARABAZËNE



16 PAQË DHE DREJTËSI, INSTITUCIONE TË FORTA



17 PARTNERIET PËR OBJEKTIVAT





BANKA PROCREDIT SHQIPËRI

- zhvilloi një sesion orientimi për karrierë në shkollën 9-vjeçare “Edith Durham”, për të prezantuar funksionimin e bankës dhe rolin e saj në ekonomi, si dhe duke nxitur edukimin financiar të nxënësve përmes temave mbi kursimin, depozitat dhe menaxhimin e parave.
- mirëpriti studentët e vitit të parë të ciklit Master nga Fakulteti i Ekonomisë në Tiranë, në kuadër të programit Jean Monnet në bashkëpunim me FEUT, duke i njohur me shërbimet bankare, kulturën organizative dhe mundësitë e punësimit e zhvillimit profesional.
- mori pjesë në “TBU Talent & Career Fair”, duke u angazhuar drejtpërdrejt me studentët për prezantimin e mundësive të praktikave dhe punësimit, si dhe të kulturës organizative të bazuar në zhvillim profesional, bashkëpunim dhe transparencë.
- mori pjesë në eventin përfundimtar të programit CybHER në Shqipëri, “Zhvillimi i talenteve në sigurinë kibernetike për një sektor më të fortë dhe gjithëpërfshirës”, duke kontribuar në diskutimet mbi lidhshmërinë, zhvillimin e talenteve dhe fuqizimin e grave dhe vajzave në fushën e sigurisë kibernetike.



BANKA RAIFFEISEN SHQIPËRI

- mbështeti dhe u përfshi në organizimin e eventit “Smells Like AI Spirit”, në Tiranë, si aktiviteti i parë i dedikuar Intelgjencës Artificiale në Shqipëri, duke kontribuar në nxitjen e inovacionit, zhvillimin e talenteve të reja dhe krijimin e një platforme për shkëmbim njohurish dhe bashkëpunim në fushën e teknologjisë.
- mbështeti festimet e Ditës së Verës në qytetin e Elbasanit, duke kontribuar në krijimin e një atmosfere festive përmes aktiviteteve tradicionale dhe kulturore, si dhe duke promovuar trashëgiminë kulturore dhe forcimin e lidhjeve me komunitetin lokal.



BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË (UBA)

- mori pjesë në panairin e karrierës të organizuar në bashkëpunim me Tirana Business University, duke mirëpritur studentë dhe i informuar mbi mundësitë e zhvillimit profesional dhe karrierës në bankë.
- mbështeti edicionin e 4-t të Konkursit të Ramazanit të organizuar nga platforma “Krijoj” në Xhaminë e Namazjasë, ku kontribuoi në promovimin e talenteve të rinj dhe vlerave kulturore përmes angazhimit të 281 artistëve në 7 kategori arti.
- organizoi darka iftari dhe shpërndau paketa ushqimore për familjet në nevojë gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit, duke kontribuar në forcimin e solidaritetit dhe mbështetjes ndaj komunitetit.



FUSHATA “ÇORAPET SHUMËNGJYRËSHE”

Banka Credins, Banka Intesa Sanpaolo Shqipëri dhe Banka OTP Shqipëri mbështetën fushatën “Çorapet Shumëngjyrëshe” të Down Syndrome Albania me rastin e Ditës Botërore të Sindromës Down, duke kontribuar në ndërgjegjësimin dhe përfshirjen sociale të personave me sindromën Down, si dhe në mbështetjen e shërbimeve terapeutike në qendrën “PRO PAK”.



| | |
|----|--|
| 6 | UJË I PASTER DHE KANALIZIME |
| 13 | VEPRIM PËR KLIMEN |
| 14 | JETA NEN UJË |
| 15 | JETA ME STERE |
| 5 | BARAZI GJINORË |
| 10 | PËRQËNIM I PARABAZËNË |
| 16 | PAQE DHE DREJTËSI, INSTITUCIONE TË FORTA |
| 17 | PARTNERIET PËR OBJEKTIVAT |



6 UJË I PASTËR
DHE KANALIZIME



13 VEPRIM
PËR KLIMËN



14 JETA
NËN UJË



15 JETA
NË STËRË



5 BARAZI
GJINORË



10 ZDRIËMI
I PARABAZËNË



16 PAQE DHE DREJTËSI,
INSTITUCIONE TË FORTA



17 PARTNERITET
PËR OBJEKTIVAT



MBËSHTETJE PËR FUQIZIMIN E VAJZAVE DHE VAJZAVE:

Banka Credins mbështeti fushatat sensibilizuese të organizuara nga UN Women në disa qytete të Shqipërisë, me synim evidentimin e progresit të grave në fusha të ndryshme të jetës dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të tyre.

Banka e Parë e Investimeve Shqipëri (Fibank) mbështeti Fondacionin "Mother & Child Hospital" me kontribut financiar për shëndetin e nënave dhe të porsalindurve, duke mundësuar zhvillimin e klasave postnatale në Maternitetin "Mbretëresha Geraldinë" për rreth 500 nëna të reja.

Banka Intesa Sanpaolo Shqipëri iu bashkua aktiviteteve ndërgjegjësuere të UN Women Albania, duke marrë pjesë në mini-turneun e futbollit për gra dhe vajza, maratonën "Ajo Vrapon" dhe duke mbështetur fushatën "Afër Zembrës" të SOS Fshatrat e Fëmijëve për gratë kryefamiljare.

Banka OTP Shqipëri iu bashkua projektit "Afër Zembrës" të SOS Fshatrat Shqipëri me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, duke mbështetur 79 nëna kryefamiljare dhe 166 fëmijë përmes blerjes së karficave të qelqta të ricikluara si simbol i forcës dhe qëndrueshmërisë.

Union Bank iu bashkua fushatës "Afër Zembrës" të SOS Fshatrat e Fëmijëve me rastin e 8 Marsit, duke mbështetur 79 nëna kryefamiljare në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe fuqizimin e tyre brenda komunitetit.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë (UBA) zhvilloi një fushatë sensibilizuese në bashkëpunim me Miriam Cani, me fokus fuqizimin e rolit të gruas dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi barazinë, respektin dhe përfshirjen aktive të grave në shoqëri.



30 ANË
DITË FSHATRA
E FËMIJËVE
SHQIPËRI





JAVA GLOBALE E PARASE 2026

16 – 22 MARS 2026

“Flasim zgjuar për paranë! – 100 vjet monedhë kombëtare!”
Java e Parasë 2026 përfshiu 4 700 fëmijë dhe të rinj nga i gjithë vendi dhe më shumë se 190 shkolla në të gjitha nivelet dhe universitetet.

Çmimet për fituesit e 5 konkurseve të organizuara nga Banka e Shqipërisë dhe Shoqata Shqiptare e Bankave me rastin e Javës së Parasë u mbështetën nga bankat:

- Konkursi për nxënësit e klasave të treta “Vizato kartëmonedhën tënde – 100 vjet monedhë kombëtare”. Në konkurrim u paraqitën mbi 475 vizatime, të realizuara nga nxënës të 75 shkollave 9-vjeçare, prej të cilave u shpallën 10 fitues. Konkursi u mbështet nga **ProCredit Bank Albania**.
- Konkursi “Projekti më i mirë” për klasat IV mbi temën “100 vjet monedhë kombëtare”. Gjithsej në konkurs u paraqitën 52 projekte, të realizuara nga rreth 1500 nxënës të 43 shkollave 9-vjeçare. Konkursi u mbështet nga **Credins Bank**.
- Konkursi me fotomontazhe (meme) për nxënësit e klasave VIII: “Flasim zgjuar për paranë!”. Gjithsej në konkurs u paraqitën 120 meme, të realizuara nga nxënës të 60 shkollave 9-vjeçare. Konkursi u mbështet nga **Banka Kombëtare Tregtare**.
- Konkursi i videos më të mirë për nxënësit e shkollave të mesme: “Flasim zgjuar për paranë!”. Në konkurs morën pjesë 175 nxënës të 40 shkollave të mesme, me 82 punime të paraqitura. Konkursi u mbështet nga **Union Bank**.
- Konkursi “Eseja më e mirë” me temë “Nga Franga dhe Leku i vitit 1926, te paraja digjitale: si ndryshon paraja dhe çfarë mbetet e pandryshuar?”. Gjithsej në konkurs u paraqitën 58 punime, të realizuara nga studentë të 13 universiteteve publike dhe jopublike të vendit. Konkursi u mbështet nga **Tirana Bank**.

Raiffeisen Bank Albania mbështet pjesëmarrjen e ekipit fitues në Kuizin Evropian të Parasë në Bruksel.





LEKSIONE TË HAPURA NË UNIVERSITETE

Në kuadër të Javës Globale të Parasë u mbajtën leksione të hapura në 3 universitete në Tiranë, duke përfshirë rreth 175 studentë, me diskutimet në tema kyçe si roli i bankave në mbështetjen e ekonomisë, ndërtimi i marrëdhënieve afatgjata me klientët, ofrimi i zgjidhjeve të personalizuara, zhvillimet kryesore të industrisë bankare, si dhe perspektivat e punësimit dhe zhvillimit profesional në këtë sektor.

- **Universiteti Polis**, mori pjesë znj. Xhilda Shehu, Head of Mass Clients Department, Retail Division në Intesa Sanpaolo Bank;
- **Universiteti i New York-ut në Tiranë**, mori pjesë znj. Edlira Zambaku, Drejtoreshë e Burimeve Njerëzore në Banka Kombëtare Tregtare;
- **Universiteti EPOKA në Tiranë**, mori pjesë znj. Elona Labinoti, Chief Operational Officer në Fibank Albania.





“STOCK MARKET LEARNING COMPETITION” 2025-2026

Bankat ishin pjesëmarrëse në “Stock Market Learning Competition”, një iniciativë e organizuar nga AAB në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe German Sparkassenstiftung Albania, që synon forcimin e edukimit financiar të stafit bankar. Pjesëmarrësit menaxhuan për tre muaj një portofol të simuluar investimesh, duke aplikuar strategji reale të tregut dhe duke thelluar njohuritë mbi investimet, menaxhimin e riskut dhe tregjet e kapitalit. Ky edicion kishte pjesëmarrje nga të gjitha bankat, me 139 punonjës në total, nga funksione të ndryshme në bankë.

PERFORMANCA E PORTOFOLIT – ÇMIME MONETARE

Vendi i parë: Kevin Caco, First Investment Bank (FiBank)
Vendi i dytë: Silvana Gurraj, United Bank of Albania (UBA)
Vendi i tretë: Eranda Loci, Tirana Bank

SUSTAINABILITY RANKING – CERTIFIKATA MIRËNJOHJE

Vendi i parë: Arlind Deda, OTP Bank Albania
Vendi i dytë: Eriola Kacani, Tirana Bank
Vendi i tretë: Juri Sejdiaj, OTP Bank Albania

RENDITJA SIPAS NUMRIT TË TRANSAKSIONEVE – CERTIFIKATA MIRËNJOHJE

Vendi i parë: Besmira Koruni, Credins Bank
Vendi i dytë: Mirvjena Mucalla, Raiffeisen Bank
Vendi i tretë: Armeti Lalollari, Banka Kombëtare Tregtare (BKT)
Vendi i katërt: Kristian Prifti, Union Bank
Vendi i pestë: Mirela Dhima, OTP Bank Albania





ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

Broshurë 3-mujori i Parë
Janar - Mars 2026

www.aab.al